ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**nema-23-13330-1-2-1**
Nr i brendshëm	**EKO-23-011-121**

Sa i përket tenderit për: Furnizim i pajisjeve të zyrës

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Emri i Kompanisë: HIGH TECH SOLUTION SHPK

Adresa : Prishtine

Numri Telefonit: 049322029

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: DRILONA AHMETI

Adresa elektronike: HIGHTECHSOLUTION.KS@GMAIL.COM

Data e parashtrimit të ankesës: 16.12.2023

Nënshkrimi dhe vula: Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuara HTS HIGH-TECH SOLUTION Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate eshte bere me date : 27.11.2023
Kerkes per informacione shtese date: 30.11.2023
Pergjigja nga ak date 04.12.2023
Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Kerkesen per rishqyrtim me date : 13.12.2023
Hapja e tenderit eshte me date : 18.12.2023 ora 13:00
Pergjigjja e kerkeses per rishqyrtim : 15.12.2023
Ankesa ne OSHP : 16.12.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	X	

Ende nuk është bere hapja e ofertave . Hapja e ofertave është planifikuar që të behet me datën : 18.12.2023

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po				**Jo**	X

Nuk aplikohet, pasi qe ende nuk është bere hapja dhe vlerësimi i ofertave

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po X **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 13.12.2023 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues – JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D.. Me datën 15.12.2023 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim të kërkesën për rishqyrtim.Gjithashtu AK-ja ketu nuk ka ditur te na ktheje pergjigjje por e ka potencuar qe ka kaluar afati per sqarime shtese nuk ka ditur te dalloje kerkesen per rishqyrtim me kerkesen per informacione shtese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Gjithashtu gjate pergaditjese kesaj procedure eshte duke u anashkaluar opinionet dhe intepretimet e KRPP-se te cilat do ti potencojme me poshte.

Shkeljet e dispozitave të Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik, që është në fuqi prej datës 01.11.2022, janë:
Neni 54.15 - Kontratat Kornizë- Çmime për njësi

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues- **JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D.**me datën **27.11.2023** ne platformën e e-prokurimit ka bere publikimin e Njoftimit për Kontrate dhe Dosjes së Tenderit për aktivitetin me numër të prokurimit: **nema-23-13330-1-2-1 Furnizim i pajisjeve të zyrës**

Kemi shkarkuar nga platforma e e-prokurimit Dosjen e Tenderit dhe menjëherë kemi vërejtur së Autoriteti Kontraktues (AK) - **JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D. ,**gjate zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bere shkelje substanciale të legjislacionit primar dhe sekondare të prokurimit publik, duke vendosur kritere të përzgjedhjes diskriminuese dhe favorizuese, duke hartuar specifika teknike të pa qarta dhe diskriminuese dhe duke mos i vendosur në Dosje të Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve sasitë indikative. Për të ju dhëne mundësi manipulimi Operatorit Ekonomik (OE) manipulues dhe të preferuar nga AK gjatë fazës se ofertimit dhe gjatë fazës se realizimit të kontratës, në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik AK ka përdore Kontratën Publike Kornize me **"çmime për njësi"**.

Në me datën **04.12.2023,** përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar të AK- Aneksi 5- Kërkesë për Informacione Shtese, ku kemi kërkuar nga AK, që ti beje korrigjimet e nevojshme, në mënyre që të ju ipet mundësi të gjithë OE të interesuar që të ofertojnë në ketë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues me datën **04.12.2023** në platformën e e-prokurimit ka bere publikimin e përgjigjeve. Në ketë përgjigjeje AK shënon së të gjitha kërkesat janë në harmoni me legjislacionin e prokurimit publik dhe nuk pranon që të beje asnjë ndryshim të kërkesave diskriminuese që ka vendosur ne Dosje të Tenderit. Gjithashtu në ketë përgjigjeje AK i jep disa arsyeje të pa qëndrueshme dhe banale lidhur me vendosjen e këtyre kritereve diskriminuese dhe jo profesionale.

Ne prape me datën **13.12.2023**, përmes platformës së e-prokurimit , kemi dërguar të AK , Kerkesen per rishqyrtim duke shfrytezuar te drejten tone qe na takon sipas LPP-se dhe e kemi derguar konform afatit ligjor , duke kerkuar te rregullohen keto pa rregullesi.

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje ligjore te neneve si me poshte:

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

--Jeni duke shkelur si primar NENIN 1 te LPP-se sepse ju nuk jeni aspak transparent efikas dhe duke shfrytezuar fondet publike ne menyre e duhur .

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

--Ju jeni duke e shkelur kete NEN sepse ju nuk jeni duke siguruar fondet publike por ju jeni duke i shkatrruar fondet publike duke keqperdorur buxhetin e shtetit duke tentuar te ipni kontraten nje OE te caktuar nga ju me cmimin me te larte.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

--Ndersa gjate pergaditjes e kesaj procedure eshte duke u shkelur ligji I prokurimit si dhe duke bere diskriminim me vendosje te kritereve dhe duke pergaditur kriteret per nje OE te caktuar.

Gjate analizimit te dosjes se tenderit dhe Aneksit 1 te dosjes se tenderit kemi verejtur qe kjo procedure eshte bere ne poentim ne

kundershtim me intepretimin e KRPP-se.

Nuk eshte respektuar opinioni i KRPP-se i dates 09.06.2023 ku thote qe :

Në rastet kur kemi të bëjmë me Kontratë publike kornizë – Furnizim – Çmime për njësi i peshuar (poentuar), Autoriteti Kontraktues është i obliguar që në Dosje të Tenderit të specifikoj normën e peshimit (poentimit) për çdo artikull.Kontratat ne furnizim duhet te kene poentimin per seilin pozicione si p.sh :

Shembulli 2:

Tabela e kalkulimit të çmimit për Kontratën Publike Kornizë - Furnizim - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar), sipas artikujve , kur vlera e parashikuar e kontratës është 100,000.00 €						
Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi i ofertës	Peshimi (poentomi) për artikuj në %	Çmimi për njësi i peshuar
1	A	copë	1	12.00	10.00	1.20
2	B	copë	1	16.00	6.00	0.96
3	C	copë	1	15.00	2.00	0.30
4	Ç	copë	1	10.00	4.00	0.40
5	D	copë	1	8.00	7.00	0.56
6	DH	copë	1	14.00	2.00	0.28
7	E	copë	1	5.00	3.00	0.15
8	Ë	copë	1	1.00	3.00	0.03
9	F	copë	1	4.00	6.00	0.24
10	G	copë	1	7.00	5.00	0.35
11	GJ	copë	1	25.00	3.00	0.75
12	H	copë	1	41.00	7.00	2.87
13	I	copë	1	13.00	1.00	0.13
14	J	copë	1	6.00	2.00	0.12
15	K	copë	1	14.00	7.00	0.98
16	L	copë	1	12.00	5.00	0.60
17	LL	copë	1	8.00	6.00	0.48
18	M	copë	1	4.00	9.00	0.36
19	N	copë	1	11.00	8.00	0.88
20	NJ	copë	1	5.00	4.00	0.20
Totali i çmimit për njësi i peshuar (1 deri 20), që shënohet në Procesverbalin e hapjes së tenderëve dhe Raportin e vlerësimit të tenderëve:					100.00 %	11.84

Duke i bazuar ne tekstin e mësipërme kërkojmë nga AK-JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D. qe se pari:

Te definoj te gjitha specifikimet teknike sepse ka te beje me pozicione te njejta 1 dhe 2

- Te vendos sasitë indikativë ne dosje te tenderit
- Te largohet poentomi saktësisht poentomi nga dosja e tenderit dhe te
- Korrigjohet ne tërësi dosja e tenderit
- **Referojuni LPP-se te cituar me larte se ne qfare raste lejohen te behen dosjet e tenderit me poentim**
- **Ne e dijme shume mire qe ky aktivitet perseritet tash e disa here dhe ju si AK dhe njesia kerkuese e dijne sakte sasin e ketyre produkteve andaj edhe eshte dashur te vendoset me sasi e jo njesi qysh keni vepruar sepse ju po e percaktoni vleren e parashikuar 30,000 mije euro a te sasia po i leni me njesi/cope kjo me te vertet eshte nje shkelje ligjore duke bere favore per OE te caktuar dhe duke eliminuar keshtu konkurencen , keshtu ju po krijoni monopolizim te tregut .**

Autoriteti Kontraktues me daten **15.12.2023** në plateformen e e-prokurimit ka bere publikimin e pergjigjejeve , por na eshte pergjigjur gabimisht duke menduar qe ne kemi bere kerkes per informacione shtese , por ne ne fakt kemi derguar KERKES PER RISHQYRTIM , pra AK-ja nuk eshte profesional ne raport me pergjigjjen ndaj OE-se.

Pasi që AK prapë nuk i beri të gjitha korrigjimet e nevojshme dhe ne harmoni me legjislacionin e prokurimit publik, ne me daten 16.12.2023, përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar të AK, Ankesen ne OSHP.

Arsyeje e shënuara në vendimin e refuzimit te Kërkesës tone për Rishqyrtim janë banale, të pa qëndrueshme , jo profesionale dhe në kundërshtim të plote me legjislacionin e prokurimit publik sepse AK-ja ne fjale ka menduar qe ne kemi derguar kerkes per informacione shtese.

Me poshtë i kemi paraqitur pretendimet tona ankimore që kemi shënuar në Kërkesën për Rishqyrtim të cilën e kemi dërguar të AK, me datën 13.12.2023, pretendime të cilat **kërkojmë që** të shqyrtohen edhe nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit sipas kësaj ankese.

Në ketë Kërkese për Rishqyrtim kemi kërkuar nga AK që ti beje këto korrigjime në Dosjen e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve:

Të vendosen sasitë indikativë në Dosje të Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve dhe të hiqet poentimi i çmimeve për njësi si kriter i vlerësimit të ofertave.

Arsyeje së pse në kërkojmë që në Dosje të Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve të vendosen sasitë indikative, dhe hiqet poentimi i çmimeve për njësi si kriter i vlerësimit te ofertave janë:

- Përdorimi i kësaj Kontratë Publike Kornizë me çmime për njësi është ne kundërshtim të plote me nenin **54.15 të Rregullores 001/2022** për Prokurim Publik.

Nga këto të dhëna të shënuara me larte lidhur me pretendimin ankimore, shihet së AK-JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D. gjate zhvillimit të këtij aktiviteti te prokurimit, deri tani ka bere shkelje substanciale të nenit 1 , 6, 7 të LPP si dhe nenit 54.15 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik që ka hy ne fuqi me datën 01.11.2023.

Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte në ketë Ankese, dëshmitë e bashkangjitura kësaj ankese dhe dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së, që kërkesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar, të kërkohet nga Autoriteti Kontraktues – JAVNO - KOMUNALNO PRODUZECE EKOLOGIJA D.D. që ti beje korrigjimet e nevojshme, konforme legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Deri tani kompania jone është dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së Ankesës për OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

Njoftimi per kontrate eshte bere me date : 27.11.2023
Kerkes per informacione shtese date: 30.11.2023
Pergjigja nga ak date 04.12.2023
Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Kerkesen per rishqyrtim me date : 13.12.2023
Hapja e tenderit eshte me date : 18.12.2023 ora 13:00
Pergjigjja e kerkeses per rishqyrtim : 15.12.2023
Ankesa ne OSHP : 16.12.2023

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*